

## NË EMËR TË POPULLIT

**Gjykata e Apelit e Kosovës** – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Gani Zabeli, kryetar kolegji, Shqipe Qerimi e Ferit Osmani, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional, Jeton Leci, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit S.A. nga fshati ..., komuna e Skenderajit, për shkak se ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, P.nr.221/2018 datë 28.09.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 26.11.2018, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, P.nr.221/18 datë 28.09.2018, **vërtetohet**.

## A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Dega në Skenderaj, P.nr.221.18 datë 28.09.2018, i akuzuari S.A. është shpallur fajtor për shkak se ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, dhe për këtë vepër i akuzuari është gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind)€ dhe dënime burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i pandehuri në afatin e verifikimit prej 2 (dy) viteve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nuk kryen vepër tjetër penale. I akuzuari është obliguar që të paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 15€ si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 15€, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Është obliguar i akuzuari që të dëmtuarës KEDS pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë, ti kompensojë dëmin e shkaktuar në lartësi prej 273, 83 €.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur Prokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, për shkak të vendimit mbi dënimin me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta ndryshoj aktgjykimin, në atë mënyrë që të akuzuarit t'i shqiptoj dënim më gjobë efektiv.

Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim, PPA/II.nr.1162/18, datë 12.11.2018 ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorit, të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe ndaj të akuzuarit të shqiptohet dënim me gjobë efektiv.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

**-ankesa është e pabazuar.**

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPP dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit.

Po ashtu, as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, në fakt me ankesë as që ka mund të kontestohet ngase i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë dhe gjyqtari individual është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj aktgjykimi i kundërshtuar u vlerësua vetëm në drejtim të pretendimeve të paraqitura në ankesë.

Sipas ankesës, Prokurorja, pretendon se Gjykata e shkallës së parë të akuzuarit i ka shqiptuar dënim të butë duke theksuar se gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të llojit dhe lartësisë së dënimit si rrethana lehtësuese për të akuzuarin ka vlerësuar pranimin e fajësisë, sjelljen korrekte të tij në gjykatë, se i njëjti është i martuar dhe baba i pesë fëmijëve, i pa punë dhe i gjendjes së dobët ekonomike ndërsa si rrethanë rënduese ka vlerësuar mënyrën e kryerjes së veprës penale. Me ankesë pretendohet se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vlerësuar në masë të duhur rëndësinë e veprës penale dhe faktin se vepra e cekur është në rritje e sipër.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore nga ankesa e Prokurorit, janë të pa bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit në mënyrë të plotë dhe gjithë përfshirëse i ka konstatuar dhe drejt i ka vlerësuar të gjitha rrethanat në pajtim me dispozitat e nenit 73 të KPRK, duke i vlerësuar si rrethana lehtësuese faktin se i akuzuari S. ka pranuar fajësinë, rrethanat e tij personale, se i njëjti është i martuar, mbajtës i familjes, baba i pesë fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa punësuar, ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarin vlerësoi mënyrën e kryerjes së veprës penale.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar drejtë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të lartcekura dhe se në ankesën e Prokurorit nuk theksohet asnjë rrethanë lehtësuese e cila nuk është vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë e që do të ndikonte në ashpërsimin e dënimit të shqiptuar ndaj të akuzuarit.

Prandaj, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka konstatuar dhe drejt vlerësuar gjykata e shkallës së parë, edhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale dhe adekuat me përgjegjësinë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe

se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit- preventiva individuale dhe ajo e përgjithshme.

Nga sa u tha më lartë në pajtim më dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E AELIT E KOSOVËS – PRISHTINË**  
**PA1.nr.1158/18 me 26.11.2018**

**Bashkëpunëtori profesional**  
**Jeton Leci**

**Kryetari i kolegjit-gjyqtari**  
**1. Gani Zabeli**

**Anëtarët e kolegjit:**

**2. Shqipe Qerimi**

**3. Ferit Osmani**